REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

# EKONOMIA DHE BUXHETI

2014






**MAJ**

# Raporti Mujor

Maj, 2014

*Kontakt:*

*e-mail: marsed.harizi@financa.gov.al*

*e-mail: ernil.sabaj@financa.gov.al*

(website - www.financa.gov.al)

# PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE....................................................................................................2

ZHVILLIMET EKONOMIKE..........................................................................................3

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit 3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave 5
4. Bilanci i Pagesave 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar 7
6. Kredia për Ekonominë 8
7. Oferta e Parasë 9
8. Depozitat sipas Burimeve 10

SEKTORI FISKAL..........................................................................................................11

1. Buxheti i Konsoliduar 11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve 12

ANEKSI STATISTIKOR.................................................................................................13

# VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin maj 2014 arriti në 117.28 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin maj ishte 1.6 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit* të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin maj 2014 ishte 101.89 lekë për dollarë dhe 139.99lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitavenë lekë* gjatë muajit majshënuan kuotat1.94 për ato 12-mujore, 1.62 për 6-mujoret dhe 1.07 për qind për depozitat 3-mujore dhe 2.12 për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 9.50 për qind për huatë 12-mujore dhe 8.61 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 1,143,5 miliardë lekë në muajin maj, duke shënuar një rritje prej rreth 0.6 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i pagesave* për peridhën T1 2014 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej 37.2 milionë euro;
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar - maj2014 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 11.7 miliardë lekë, ose 71.5 për qind më pak e planit për këtë muaj ( e cila ishte 29.5miliardë);
- *Të ardhuratgjithsej* të realizuara gjatë periudhës janar - maj 2014,arritën në rreth 144.587 miliardë lekë, ose 102.6 për qind e planit për muajin;
- *Shpenzimet gjithsej* gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 156.331 miliardë lekë, ose 85.8 për qind e shpenzimeve të planifikuara për këtë muaj.

# ZHVILLIMET EKONOMIKE

## 1.Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin maj 2014shënoi një rënie prej 1.1 për qind krahasuar me muajin prill '14, kur ky indeks shënonte një rënie prej 0.6 për qind, krahasuar me muajin paraardhës. Ndërsa gjatë muajit mars '14, ky indeks ishte 0.5 për qind më i i lartëse në muajin shkurt '14. Ndryshimet respektive me të njëjtët muaj të një viti më parë ishin 1.6 për qind, 1.7 për qind dhe 2.2 për qind. Rënia me e madhe mujore,gjatë muajit maj u konstatua në grupin "Shëndeti" me 5.34për qind. Pesha specifike relativisht e ulët që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte të ulëta mbi normën e inflacionit (rreth 0.2 pikë përqindjeje). Ndërsa rritja më e madhe u konstatua në grupin "Mallra dhe shërbime të ndryshme" me 8.01 për qind (duke kontribuar me 0.4 pikë përqindje në normën e inflacionit).

Fig-1




***Ndryshimet mujore të IÇK-së***

**Burimi: INSTAT**

Norma vjetore e inflacionit në muajin majarriti në 1.6 për qind, duke qëndruar poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2013 dhe 2014 paraqiten në tabelën 1.

Tab - 1 *Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)*

| *VITI* | Janar | Shkurt | Mars | Prill | **Maj** | Qershor |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ***2013*** | 2.7 | 2.5 | 2.4 | 2.3 | 2.1 | 2.3 |
| ***2014*** | 1.7 | 1.9 | 2.2 | 1.7 | **1.6** | |
| *VITI* | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
| ***2013*** | 1.6 | 1.2 | 1.7 | 1.7 | 1.0 | 1.9 |
| ***2014*** | | | | | | |

*Burimi: INSTAT*

## 2.Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin maj 2014, arriti në 139.99 lekë/euro, duke shënuar një rënieme 0.01 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit maj, një euro u këmbye me 139.86 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin maj 2014, arriti në 101.89 lekë/dollarë duke shënuar një rritje prej 0.5 për qind kundrejt muajit prill '14. Në fund të muajit maj, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 102.72 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin majtë vitit të kaluar,rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 6.1për qind, ndërsa kundrejt monedhës europiane euro është mbiçmuar me 0.6 për qind. Nënçmimi dhe mbiçmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane euro dhe monedhës amerikane, në radhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rënie mesatare duke arritur në rreth 0.728 euro/dollarë.

Fig-2




*Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit maj'14*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji, përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

# 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit maj2014, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 1.94 për qind, duke shënuar një rënie me 0.27 pikë përqindje krahasuar me muajin prill 2014. Rënie për këtë muaj ka patur edhe nënormat e interesit të depozitave me afate të maturimit 1, 3 dhe 6 -mujore respektivisht me 0.09, 0.15 dhe 0.18 pikë përqindje, duke shkuar përkatësisht në 2.12, 1.07 dhe në 1.62 për qind.Rritje për këte muaj nuk ka patur në asnjë prej normavetë interesit të depozitave.Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kanë pësuar rënie normat e interesit të depozitave për të gjitha afatet e maturimit 1, 3, 6 dhe 12-mujore.

Fig-3




***Normat e interesit për depozitat (%)***

**Burimi: Banka e Shqipërisë**

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit majpësoi një rritje me 0.9 pikë përqindje, duke arritur në 9.50 për qind nga 8.60 për qind që ishte në muajin prill2014. Për këtë muaj, norma e interesit të huave 6-mujore shënuan një rritje me 0.61 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin maj arriti në 8.61për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kanë pësuar rënie normat e interesit të huave me afate maturimi 6 dhe 12-mujore.

Fig-4




***Normat e interesit për huatë dhe bonot (%)***

**Burimi: Banka e Shqipërisë**

Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit maj2014, për bonot 12, 6 dhe 3-mujore ishin përkatësisht 3.40, 3.27 dhe 3.05 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re një rënie në *yield*-et e bonove të thesarit për të gjitha afatet e maturimit 12-mujore, 6-mujore dhe ato 3-mujore, me respektivisht 0.16, 0.05 dhe 0.09 pikë përqindje.

# 4.Bilanci i Pagesave

Bilanci i pagesave për periudhën janar–mars 2014 regjistroi njëdeficit të përgjithshëm prej 37.2 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në figurën 5, ku kontributin më të madh në të e jep zëri i "Llogaria korrente" së bashku me nënzërat e saj, me -299.5 milionë euro, duke u ulur me 30.2% krahasuar me 3-mujorin e parë të vitit 2013. "Llogaria kapitale dhe financiare" për 12-mujorin e vitit 2013-të rezultoi të jetë -253.5 milionë euro, ose gati 8.1% më e lartë se në 3-mujorin e parë të vitit 2013.

Fig-5




***Bilanci i Pagesave T1 2014***

**Burimi: Banka e Shqipërisë**

Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente prej -299.5 milionë euro, i shprehur sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për periudhën janar – mars '14 rezultoi: *(i)* bilanci tregtar -356.2 mln euro, *(ii)* shërbime neto -52.4 mln euro, *(iii)* të ardhura neto -31.3 mln euro, (iv) transferta neto 140.3 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.

Fig-6




***Llogaria Korente T1 2014***

**Burimi: Banka e Shqipërisë**

# 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit maj 2014, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 17,465.8 milionë lekë krahasuar me majine vitit 2013. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në bankat e nivelit të dytë me rreth 27,338.0 milionë lekë.Në zvogëlimin e këtij efekti rritës ndikoi nga ana tjetër dhe rënia e mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë, me rreth 9,872.2 milionë lekë.

Fig-7




***Ecuria e M.V.N. të sistemit në maj'13 - maj'14***

**Burimi: Banka e Shqipërisë**

Fig-8




***Agregati M3 maj'13 - maj'14***

**Burimi: Banka e Shqipërisë**

Në muajin maj ’14 sistemi bankar rezulton me një rritje prej3,045.9 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin prill ‘14, rritje e cila erdhi si rezultat i rritjes së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 1,732.3 milionë lekë dhe e rritjes së nivelit të mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 1,313.6 milionë lekë duke e ndihmuar edhe më tepër rritjen e mjeteve valutore neto të sistemit bankar.

# 6. Kredia për Ekonominë

Teprica e kredisë për ekonominë për muajin maj2014 arriti në 545.5 miliardë lekë. Rënia e tepricës së kredisë, krahasuar me fundvitin 2013 shënoi vlerën 2.4 miliardë lekë, me një rënie të lehtë prej rreth 0.4 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 59.5 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 324.5 miliardë lekë. Gjatë muajit maj 2014, zëri "Korporata të tjera jofinanciare", zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 66.4 për qind ose 362.1 miliardë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin e 27.4 për qind ose 149.7 miliardë. Zërat "Korporata jofinanciare publike" dhe "Korporata të tjera financiare" arritën respektivisht 4.56 dhe 1.58 për qind apo 24.9 dhe 8.6 miliardë lekë.

Fig-9




***Rritja e stokut total të kredive***
*Burimi: Banka e Shqipërisë*

Fig-10




***Përberja e kredive maj '14***
**Burimi: Banka e Shqipërisë**

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin maj'14, zëri "Korporata të tjera jofinanciare" zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 55.8 për qind, ndjekur nga "Sektorë të tjerë rezidentë" me rreth 33.3 për qind dhe nga "Korporata publike jofinanciare", me 9.1 për qind. "Korporata të tjera jofinanciare" dhe "Sektorë të tjerë rezidentë" zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.57 për qind dhe rreth 23.44 për qind.

# 7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin maj ka shënuar një rritje krahasuar me muajin paraardhës prill 2014. Kjo ofertë arriti në rreth 1,143.5 miliardë lekë në fund të muajit maj'14 duke shënuar një rritje prej 2.0 miliardë lekë kundrejt nivelit të regjistruar në muajin prill'14. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 0.6 për qind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i dy viteve më përpara. Ndërsa krahasuar me muajin paraardhës prill'14, oferta e parasë pësoi një rritjetë lehtë prej 0.2 për qind.

Fig-11




***Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-12




***Raporti i Depozitave ndaj M3***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rënie prej 3.9 miliardë lekë në krahasim me muajin maj2013. Depozitat në valutë gjatë muajit maj'14 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 86.6 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë sektori i individëve ka zënë rreth 88.8 për qind të tyre.

# 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit maj2014, zëri "Sektorë të tjerë rezidentë" zuri nivelin më të lartë të depozitave të trasferueshme në lekë, me rreth 88.8 për qind, ndjekur nga "Korporata të tjera jofinanciare", me rreth 8.6 për qind dhe nga "Korporata jofinanciare publike", me 1.9 për qind. "Sektorë të tjerë rezidentë" dhe "Korporata të tjera jofinanciare" ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 86.6 për qind dhe rreth 11.0 për qind. "Sektorë të tjerë rezidentë" ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 87.7 për qind e totalit (në lekë).

Fig-13




***Rritja e stokut total të depozitave***

**Burimi: Banka e Shqipërisë**

Në përgjithësi, "Sektorë të tjerë rezidentë" përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 832.4 miliardë) të depozitave totale, prej rreth 949.0miliardë lekë në muajin maj2014. Ata ndiqen nga "Korporata të tjera jofinanciare" (92.4 miliardë), "Korporata jofinanciare publike" (15.1 miliardë) dhe "korporata të tjera financiare" (7.5 miliardë). "Qeveria lokale" kontribuoi me rreth 1.6 miliardë në totalin e depozitave. Gjatë muajit maj 2014, krahasuar me një muaj më parë, niveli i përgjithshëm i depozitave pësoi një rritje prej 0.9 miliardë lekë, kjo si rezultat i rritjessë depozitave në valutë me rreth 0.6 milliardë lekë si dhe e rritjes së depozitave në lekë me rreth 0.3 miliardë lekë.

Fig-14




***Përberja e depozitave maj '14***

**Burimi: Banka e Shqipërisë**

# SEKTORI FISKAL

## 1.Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar - maj 2014 janë mbledhur rreth 144.587 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 156.331 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin131.2 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 13.7 milionë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat33.6% janë financim i brendshëm.

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 102.6% të të ardhurave buxhetore për planin e periudhës, ndërsa shpenzimet përbëjnë rreth 85.8% të këtij plani. Shpenzimet korrente janë rreth 94.7% e planifikimit të periudhës të këtij zëri, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 67.1% të tij.

Fig - 15




***Treguesit Fiskal, janar - maj 2014***

**Burimi: Ministria e Financave**

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 98.3 miliardë lekë (ose rreth 100.9% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 5.4miliardë lekë (ose rreth 129.1% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 26.1 miliardë lekë (ose rreth 99.3% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 10.6 miliardë lekë (ose rreth 118.6% e planit të periudhës).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 131.2 miliardë lekë, 29.1 miliardë lekë (22.2% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 17.3 miliardë lekë (13.1%) për interesat, 9.7 miliardë lekë (7.4%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 422 milionë lekë (0.3%) për subvencione, 54.4 miliardë lekë (41.4%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 9.9 miliardë lekë (7.6%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 10.5 miliardë lekë (8%) për shpenzimet e tjera.Këto përfaqësojnë 39.3% (shpenzime personeli), 37.2% (shpenzime për interesat), 27.4% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 26.4% (subvencione), 39.9% (sigurimetshoqërore dhe shëndetësore), 30% dhe 45.8% (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishte 16.1%, ndërsa financimi i huaj është 23.6% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar - maj 2014 ishin rreth 144.6 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 129.9 miliardë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 10.6 miliardë lekë.

Tab - 2 *Të ardhurat gjatë janar - maj 2014 (në mld Lekë)*

| Burimi | maj '14 | maj'13 | Ndryshimi në (%) |
|---|---|---|---|
| TVSH | 50.3 | 41.8 | 20.3 |
| Tatimi mbi fitimin | 9.5 | 7.6 | 25 |
| Taksa doganore | 2.3 | 2.2 | 4.5 |
| Taksat nacionale | 12.9 | 10.7 | 20.6 |
| Akcizat | 12.5 | 13.5 | -7.4 |
| Tatim mbi të ardhuart personale (TAP) | 10.9 | 12.0 | -9.2 |

*Burimi: Ministria e Financave: Statistika Fiskale Mujore: janar -maj 2014.*

## 3.Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 11.7 miliardë lekë, për periudhën janar - maj 2014, u mbështet në vlerën 10.5 miliardë lekë nga burime të brendshme dhe rreth 1.25 miliardë nga burime të jashtme. Huamarrja e brendshme ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm (rreth 148.4% të totalit të huamarrjes së brendshme), ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afatgjata (rreth 404.3% të totalit të huamarrjes së huaj për periudhën janar - maj 2014).

Për muajin maj 2014, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 28.376 miliardë lekë.
- Realizimi i shpenzimeve në masën 33.032miliardë lekë

Në realizimin e të ardhurave për muajin maj 2014, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat kapin shifrën e 26.2 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 27.2 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 2.2 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

| | Mujor (Monthly ) | | | | | | Mesatar Mujor (Monthly Average) | | | | | | Vjetor (Annual) | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Muaji | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | **2014** | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | **2014** | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | **2014** | Month |
| Janar | 0.4 | 0.9 | 0.8 | 0.7 | 1.0 | 0.8 | 0.40 | 1.00 | 0.80 | 0.71 | 1.00 | 0.80 | 2.1 | 3.6 | 3.3 | 1.6 | 2.7 | 1.7 | January |
| Shkurt | 0.7 | 1.1 | 2.3 | 1.3 | 1.1 | 1.4 | 0.55 | 1.02 | 1.55 | 1.01 | 1.05 | 1.10 | 1.9 | 4.7 | 4.5 | 0.6 | 2.5 | 1.9 | February |
| Mars | 0.6 | 0.1 | -0.1 | 0.4 | 0.2 | 0.5 | 0.57 | 0.71 | 1.00 | 0.80 | 0.77 | 0.90 | 1.6 | 4.1 | 4.3 | 1.0 | 2.4 | 2.2 | March |
| Prill | -0.1 | -0.4 | -0.6 | -0.1 | -0.1 | -0.6 | 0.40 | 0.42 | 0.60 | 0.58 | 0.55 | 0.53 | 1.9 | 3.7 | 4.1 | 1.6 | 2.3 | 1.7 | April |
| **Maj** | -0.8 | -1.2 | -1.1 | -0.8 | -1.0 | **-1.1** | 0.16 | 0.10 | 0.26 | 0.32 | 0.24 | **0.20** | 2.1 | 3.3 | 4.2 | 1.9 | 2.1 | **1.6** | **May** |
| Qershor | -0.6 | -0.7 | -1.1 | -0.8 | -0.6 | | 0.03 | -0.04 | 0.04 | 0.12 | 0.16 | | 2.3 | 3.2 | 3.9 | 2.2 | 2.3 | | June |
| Korrik | -0.7 | -0.5 | -0.7 | -0.2 | -0.8 | | -0.07 | -0.10 | -0.07 | 0.08 | -0.03 | | 2.2 | 3.4 | 3.6 | 2.7 | 1.6 | | July |
| Gusht | 0.7 | 0.8 | 0.3 | 0.4 | -0.1 | | 0.03 | 0.01 | -0.02 | 0.12 | -0.04 | | 2.2 | 3.5 | 3.1 | 2.8 | 1.2 | | August |
| Shtator | 0.8 | 0.7 | 0.4 | 0.2 | 0.8 | | 0.11 | 0.09 | 0.02 | 0.13 | 0.06 | | 2.0 | 3.4 | 2.8 | 2.6 | 1.7 | | September |
| Tetor | 0.4 | 0.2 | 0.4 | 0.2 | 0.1 | | 0.14 | 0.10 | 0.06 | 0.14 | 0.06 | | 2.3 | 3.0 | 3.0 | 2.4 | 1.7 | | October |
| Nëntor | 0.4 | 0.2 | 0.1 | 0.2 | -0.5 | | 0.16 | 0.11 | 0.06 | 0.14 | 0.01 | | 2.8 | 2.8 | 2.9 | 2.5 | 1.0 | | November |
| Dhjetor | 1.6 | 2.2 | 1.0 | 0.9 | 1.7 | | 0.28 | 0.28 | 0.14 | 0.20 | 0.15 | | 3.7 | 3.4 | 1.7 | 2.4 | 1.9 | | December |

*Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë* *Source : INSTAT,Bank of Albania*

**Tab - 2** **Kursi i këmbimit**

Exchange rate

Lekë për njësi të monedhës së huaj *(Lek per unit of foreign currency)*

| Monedha | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | | | | | Currency |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Jan | Feb | Mar | Apr | May | |
| *Mesatarja e periudhës* | | | | | | | | | | | *Average of period* |
| USD | 94.98 | 103.94 | 100.90 | 108.18 | 105.67 | 103.24 | 102.75 | 101.55 | 101.35 | 101.89 | USD |
| EURO | 132.06 | 137.79 | 140.33 | 139.04 | 140.27 | 140.54 | 140.32 | 140.29 | 140.01 | 139.99 | EURO |
| *Fundi i periudhës* | | | | | | | | | | | *In the end of period* |
| USD | 95.81 | 104.00 | 107.54 | 105.85 | 101.86 | 103.66 | 101.58 | 101.89 | 101.36 | 102.72 | USD |
| EURO | 137.96 | 138.77 | 138.93 | 139.59 | 140.20 | 140.44 | 140.14 | 140.27 | 140.08 | 139.86 | EURO |

*Burimi : Banka e Shqipërisë* *Source : Bank of Albania*

Tab - 3

**Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)**

Annual Interest Rates (in ALL)

| | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Në përqindje | | | | | | Jan | Feb | Mar | Apr | May | In percent |
| **Norma e depozitave** | | | | | | | | | | | **Deposits rates** |
| 12-M | 6.78 | 6.07 | 5.87 | 5.38 | 4.17 | 2.39 | 2.46 | 2.16 | 2.21 | 1.94 | 12-M |
| 6-M | 5.74 | 5.16 | 4.87 | 4.50 | 3.40 | 1.87 | 1.87 | 1.66 | 1.80 | 1.62 | 6-M |
| 3-M | 5.05 | 4.42 | 4.22 | 3.83 | 2.72 | 1.31 | 1.53 | 1.12 | 1.22 | 1.07 | 3-M |
| 1-M | 4.56 | 4.70 | 4.39 | 3.62 | 2.79 | 2.43 | 2.51 | 2.25 | 2.21 | 2.12 | 1-M |
| **Norma e huasë** | | | | | | | | | | | **Lending rates** |
| 12-M | 12.46 | 11.52 | 11.17 | 10.28 | 9.52 | 8.67 | 8.49 | 6.47 | 8.60 | 9.50 | 12-M |
| 6-M | 12.54 | 11.69 | 12.28 | 10.61 | 9.59 | 9.36 | 8.77 | 9.34 | 8.00 | 8.61 | 6-M |
| **Norma e letrave me vlerë** | | | | | | | | | | | **Securities rates** |
| Bono thesari 1/ | | | | | | | | | | | Treasury bills 1/ |
| 3-M | 6.30 | 5.29 | 5.31 | 5.03 | 3.40 | 3.36 | 3.24 | 3.14 | - | 3.05 | 3-M |
| 6-M | 7.52 | 6.41 | 6.23 | 5.65 | 3.54 | 3.71 | 3.52 | 3.40 | 3.32 | 3.27 | 6-M |
| 12-M | 9.14 | 7.09 | 6.95 | 6.37 | 3.66 | 3.82 | 3.79 | 3.66 | 3.56 | 3.40 | 12-M |

*Burimi : Banka e Shqipërisë* *Source : Bank of Albania*

Tab - 4

**TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2014**

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2014

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* — *në milionë Lekë (in million Lek)*

| Nr. | E M Ë R T I M I | Janar January | Shkurt February | Mars March | Prill April | Maj May | ITEMS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **TOTALI TË ARDHURAVE** | **27,774** | **53,273** | **82,107** | **116,161** | **144,587** | **TOTAL REVENUE** |
| I. | **Të ardhura nga ndihmat** | **624** | **1,658** | **2,991** | **3,507** | **4,053** | **Grands** |
| II. | **Të ardhura tatimore** | **24,326** | **47,226** | **73,627** | **103,682** | **129,906** | **Tax Revenue** |
| II.1 | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **17,534** | **35,349** | **56,298** | **77,924** | **98,335** | **From tax offices and customs** |
| 1 | Tatimi mbi Vlerën e Shtuar | 9,472 | 19,155 | 28,677 | 40,626 | 50,331 | V.A. T |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 1,007 | 2,363 | 6,332 | 7,950 | 9,477 | Profit Tax |
| 3 | Akcizat | 1,616 | 3,660 | 6,110 | 9,083 | 12,500 | Excise Tax |
| 4 | Tatimi mbi të Ardhurat Personale | 2,569 | 4,576 | 6,444 | 8,716 | 10,903 | Personal Income Tax |
| 5 | Taksa Nacionale dhe të tjera | 2,482 | 4,806 | 7,494 | 9,842 | 12,869 | National Taxes and others |
| 6 | Taksa Doganore | 388 | 789 | 1,241 | 1,707 | 2,255 | Customs Duties |
| II.2 | **Të ardhura nga Pushteti Vendor** | **796** | **1,340** | **2,162** | **4,462** | **5,448** | **Revenues from Local Gov.** |
| 1 | Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat) | 154 | 340 | 663 | 1,691 | 1,931 | Property Tax |
| 2 | Taksë mbi Biznesin e vogël | 304 | 329 | 350 | 379 | 612 | Small Business Tax |
| 3 | Taksa Lokale | 338 | 671 | 1,149 | 2,392 | 2,905 | Local Taxes |
| II.3 | **Të ardh nga fondet speciale** | **5,996** | **10,537** | **15,167** | **21,296** | **26,123** | **Social ins. contributions** |
| 1 | Sigurimi Shoqeror | 5,257 | 9,209 | 12,860 | 18,429 | 22,562 | Social Insurance |
| 2 | Sigurimi Shëndetsor | 735 | 1,319 | 2,283 | 2,831 | 3,522 | Health insurance |
| 3 | Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve | 4 | 9 | 24 | 36 | 39 | Revenues for property compesation |
| III. | **Të ardhura Jotatimore** | **2,824** | **4,389** | **5,489** | **8,972** | **10,628** | **Nontax Revenue** |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë | 165 | 320 | 430 | 1,871 | 1,951 | Profit transfer from BOA |
| 2 | Të ardhura nga Inst.Buxhetore | 1,810 | 2,630 | 3,254 | 4,818 | 5,654 | Income of budgetary institutions |
| 3 | Dividenti | 498 | 498 | 498 | 498 | 504 | Divident |
| *4* | Tarifat shërbimeve | 139 | *404* | 612 | *842* | 1,363 | Tariffs on servises |
| 5 | Të tjera | 212 | 537 | 695 | 943 | 1,156 | Other/not allocated |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **24,963** | **54,269** | **88,415** | **122,526** | **156,331** | **TOTAL EXPENDITURE** |
| I. | **Shpenzime Korrente** | **24,285** | **51,451** | **77,884** | **103,308** | **131,222** | **Current Expenditures** |
| I.1 | **Personeli** | **5,645** | **11,394** | **17,268** | **23,174** | **29,083** | **Personnel expenditures** |
| 1 | Paga | 4,856 | 9,811 | 14,864 | 19,954 | 25,031 | Wages |
| 2 | Kontributi për Sigurime Shoqerore | 789 | 1,583 | 2,404 | 3,220 | 4,052 | Social insurance contributions |
| I.2 | **Interesat** | **3,819** | **7,843** | **10,675** | **13,039** | **17,255** | **Interest** |
| 1 | Të Brendshme | 3,476 | 7,058 | 9,502 | 11,290 | 15,144 | Domestic |
| 2 | Të Huaja | 343 | 785 | 1,173 | 1,749 | 2,111 | Foreign |
| I.3 | **Shpenzime Operative Mirëmbajtje** | **1,275** | **3,225** | **6,425** | **8,256** | **9,670** | **Operational & Maintenance** |
| I.4 | **Subvecionet** | **58** | **112** | **265** | **310** | **422** | **Subsidies** |
| I.6 | **Shpenzime për fonde speciale** | **9,440** | **20,875** | **31,372** | **42,422** | **54,379** | **Social insurance outlays** |
| 1 | Sigurime Shoqerore | 7,432 | 15,127 | 23,165 | 31,405 | 39,633 | Social insurance |
| 2 | Sigurime Shëndetsore | 2,008 | 4,754 | 7,213 | 10,023 | 13,752 | Health insurance |
| 3 | Fondi I kompensimit te pronareve | | | 994 | 994 | 994 | Expenditures for Owners Compensation |
| I.7 | **Shpenzime per Buxhetin Vendor** | **1,214** | **3,120** | **5,041** | **7,535** | **9,927** | **Local budget expenditure** |
| I.8 | **Shpenzime të tjera** | **2,834** | **4,882** | **6,838** | **8,572** | **10,486** | **Other expenditures** |
| 1 | Pagesa e Papunesisë | **112** | 198 | 294 | 387 | 454 | Unemployment insurance benefits |
| 2 | Ndihma Ekonomike | 2,721 | 4,684 | 6,544 | 8,170 | 9,970 | Social assistance |
| 5 | Kompensimi i ish-të përndjekurve politike | 300 | 300 | 0 | 15 | 62 | Compansation for ex-political prisioners |
| III | **Shpenzime Kapitale** | **678** | **2,818** | **10,531** | **11,466** | **13,734** | **Capital expenditures** |
| 1 | Financimi Brendshëm | 0 | 641 | 1,309 | 4,025 | 4,615 | Domestically financing |
| 2 | Financimi Huaj | 678 | 2,177 | 9,222 | 7,441 | 9,119 | Foreign financed |
| | **DEFICITI** | **2,811** | **-996** | **-6,308** | **-6,365** | **-11,744** | **CASH BALANCE** |
| | **FINANCIMI DEFICITIT** | **-2,811** | **996** | **6,308** | **6,365** | **11,744** | **CASH BALANCE FINANCING** |
| | **Brendshëm** | **-2,179** | **1,745** | **1,959** | **5,673** | **10,493** | **Domestic** |
| | Të ardhura nga privatizimi | 0 | 1 | 1 | 2 | 4 | Privatization receipts |
| | Hua-marrje e brendshme | 3,473 | 4,696 | 8,647 | 11,026 | 15,576 | Domestic new borrowing (net) |
| | Nacionale | 3,482 | 4,707 | 8,660 | 11,048 | 15,600 | Other |
| | Lokale | -9 | -11 | -13 | -22 | -24 | Foreign |
| | Të tjera | -5,652 | -2,952 | -8,208 | -4,474 | -5,818 | Other |
| | Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë | 1,838 | 4,269 | 771 | 2,125 | 3,815 | Government deposits into the Central Bank |
| | Të tjera | -7,489 | -7,219 | -8,978 | -6,598 | -9,631 | Other |
| | Depozita e ISSH dhe ISKSH | -3,545 | -3,102 | -3,585 | -3,093 | -4,137 | Deposits of Socila and Health insurance |
| | Mjete në ruajtje | 6 | 57 | 23 | 120 | 124 | Preservation stock |
| | Nënhua | 314 | 369 | 552 | 916 | 1,029 | On-Loan Principal |
| | Detyrim ndaj ISSH | -220 | -99 | -303 | 712 | 78 | Liabilities to SSI |
| | Të tjera (detyrime të përkohshme) | -4,044 | -4,444 | -6,689 | -450 | 242 | Other-Float |
| | **I huaj** | **-632** | **-749** | **1,366** | **617** | **1,304** | **Foreign** |
| | Hua afatgjatë(e marrë) | 198 | 534 | 3,153 | 3,996 | 9,562 | Long-term foreign borrowing (gross) |
| | Nga e cila nënhua | 0 | | 1,665 | 1,642 | 1,670 | |
| | Ndryshimi i gjendjes së arkes* | -142 | -44 | 51 | 185 | 240 | Chang. of stat. Account |
| | Ripagesat | -688 | -1,385 | -1,984 | -7,399 | -8,498 | Repayments |

*Burimi : Ministria e Financave* — *Source : Ministry of Finance*

*"Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit*

* *"Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja*

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2014**

Table of investments 2014

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë ( in million Lek)*

| | Janar<br>January | Shkurt<br>Feb | Mars<br>Mar | Prill<br>Apr | Maj<br>May | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Financim i brendshëm** | **0** | **641** | **1,309** | **4,025** | **4,615** | **Domestic financing** |
| *Në %* | *0.00* | *22.75* | *12.43* | *35.10* | *33.60* | *In %* |
| **Financim i huaj** | **678** | **2,177** | **9,222** | **7,441** | **9,119** | **Foreign financing** |
